



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 3121/3 Prot.

Tiranë, më 09/10/2012

**Lënda:** Urdhër për Kontrolluesin "Insig" sh.a Tiranë.

**U R D H E R**  
Nr 05 ,datë 09/10/12

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të Kontrolluesit "Shyze" sh.p.k Tiranë.

**KONSTATOVA**

Në zbatim të urdhrit nr.139 datë 03/09/2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar inspektimin administrativ pranë kontrolluesit "Insig" sh.a Tiranë me objekt:

- Instalimi, përdorimi, mbikëqyrja dhe regjistrimi me anën e "Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi" (CCTV), në ambientet e kontrolluesit "Insig".
- Verifikimi i përdorimit të këtyre kamerave bazuar në nenet 5 dhe 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe udhëzimin nr 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" në lidhje me:
  - Qëllimin e përpunimit të imazheve, si të dhëna personale me karakter të veçantë fizik;
  - Mjaftueshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të këtyre të dhënave përkundrejt qëllimit;
  - Saktësinë dhe qartësinë në përpunimin e imazheve, gjatë vëzhgimit dhe regjistrimit të tyre;
  - Kohën e ruajtjes së imazheve filmike apo fotove të gjeneruar nga sistemi i ruajtjes dhe i regjistrimit;
  - Kategoritë e subjekteve që ju përpunohen imazhet dhe mënyrat e përpunimit të tyre për identifikimin e subjekteve;
  - Përhapjen e të dhënave të mbledhura e të përpunuara me anën e CCTV-ve, tek të tretët;

- Numrin e kamerave të vendosura në ambientet e kontrolluesit dhe nëse ka instalime të kamerave të fshehta;
- Ezaurimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave, që ju përpunohet e dhëna “imazhe”, me anën e “Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi” (CCTV), bazuar ne nenet 12,13,18,19 te ligjit nr. 9887,dt 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe në udhëzimin nr.3 date 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, në lidhje me:
  - Informimin e subjekteve që i nënshtrohen vëzhgimit dhe regjistrimit, me anën e tabelave informuese apo me çdo forme tjetër të shkruar;
  - Rastet, nëse kontrolluesit i është kërkuar nga subjekti i të dhënave përmbushja e të drejtës për akses në përpunimin e të dhënave me anën e CCTV-ve, si dhe nëse është kërkuar korrigjimi apo fshirja e këtyre të dhënave;
- Siguria dhe politikat e privatësisë për përpunimin e të dhënave me anën e sistemit të CCTV-ve, bazuar në ligjin nr 9887,dt 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe në udhëzimin nr.3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” në lidhje me:
  - Vendosjen e kontrollit në aksesin e të dhënave të përpunuara nga CCTV dhe përgjegjësitë në administrimin e këtyre të dhënave;
  - Nivelin e sigurie fizike dhe teknike të sistemit të “Kamerave Vëzhgim-Regjistrimit” (CCTV);
  - Verifikimin, nëse ka në fuqi ndonjë rregullore të veçante për përpunimin e të dhënave me anën e sistemit të CCTV-ve;

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ, pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

1. Kontrolluesi “*Insig*”sh.a ka instaluar dhe përdor për mbikëqyrje dhe regjistrim sistemin e “Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi” (CCTV) në ambientet e tij ku përfshihen, zyra e sekretares së Drejtorit të Përgjithshëm, zyra e Auditit të brendshëm, zyra e Dëmeve, zyra e Financës, zyra Juridike, zyra e Degës së Tiranës dhe zyra e shitjes së kësaj dege .

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson që qëllimi për të cilin përdoret sistemi i “Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi” pra “siguria e ambienteve të kontrolluesit nga dëmtimet, siguria e vlerave monetare, siguria e punonjësve dhe klientëve”, realizohet mjaftueshëm me vendosjen e “Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi” në hyrjet e daljet e ambienteve dhe nuk është e nevojshme përdorimi i tyre në zyrat e: Sekretares së Drejtorit të Përgjithshëm, Auditit të brendshëm, Dëmeve, Financës, Juridike, Degës së Tiranës, shitjes së Tiranës pasi:

Godina ku janë vendosur ambientet e punës është nën administrimin e një subjekti privat, të gjithë personat që futen në godine kontrollohen fillimisht nga punonjësi i shoqërisë së sigurisë fizike. Kontrolli fizik realizohet përmes aparaturave të posaçme. Regjistrohet identiteti i të gjithë personave të interesuar për të kontaktuar me subjekte të cilat kryejnë aktivitetin e tyre brenda godinës.

Punonjësit e Kontrolluesit janë pajisur me karta aksesi dhe të gjitha hyrjet dhe daljet e tyre në ambientet e punës regjistrohen.

Kontrolluesi nuk ka për qëllim kontrollin e punonjësve lidhur me disiplinën dhe rendimentin e tyre në punë.

Monitorimi i vazhdueshëm duhet të përdoret vetëm në rrethana të veçanta dhe vetëm nëse qëllimi për të cilin është instaluar ky sistem nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër.

Përdorimi në këtë mënyrë i sistemit të *"Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi"* në këto ambiente përbën ndërhyrje në jetën private të punonjësve dhe klientëve, të drejtat e të cilëve janë të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për *"Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut"* si dhe ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*.

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale të klientëve dhe punonjësve nëpërmjet përdorimit të sistemit të *"Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi" (CCTV)* në këto ambiente është e tepërt dhe jo proporcionale lidhur me qëllimin, për të cilin përdoret ky sistem, duke qenë në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* nenin 5 pika 1 germa "c"... *"Mbrojtja e të dhënave personale bazohet ; në mjaftueshmërinë e të dhënave,të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim"*
  - Udhëzimin nr.3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale *"Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera"* pika 4 germa a .... *"Sistemi i video survejimit nuk duhet të ndërhyje në jetën private të individëve. Përpunimi i të dhënave me anë të sistemit të video survejimit mund të lejohet vetëm nëse qëllimi për të cilin është instaluar ky sistem nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër"*
  - Udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale *"Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera"* pika 4 germa f ... *"instalimi dhe përdorimi i sistemit të video survejimit duhet të bëhet në atë formë që përpunimi i të dhënave të kryhet në përputhje me të drejtat themelore të njeriut,të drejtën për privatësi dhe të drejtën për jetë private dhe familjare. Këto të drejta janë të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut i miratuar me ligjin nr.8137,datë 31.07.1996,si dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale"*
2. Kontrolluesi *"Insig" sh.a* nuk ka hartuar rregullore për qëllimin, mënyrat e mbledhjes, ruajtjes dhe përpunimit, të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të *"Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi" (CCTV)* në ambientet e tij, detyrim ky i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave personale, duke qenë në kundërshtim me:
- Nenin 27/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*...*Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të pa autorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi"*.

Sa më sipër:

## URDHËROJ

1. Në zbatim të nenit 5 pika 1/c të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera":
  - Të ndalohet mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale përmes përdorimit të sistemit të "Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi" në: Zyrat e Sekretares së Drejtorit të Përgjithshëm, Auditit të brendshëm, Dëmeve, Financës, Juridike, Degës së Tiranës, shitjes së Tiranës.
  - Te shkatërrohen të dhënat personale të mbledhura dhe të përpunuara përmes përdorimit të sistemit të "Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi" në: Zyrat e Sekretares së Drejtorit të Përgjithshëm, Auditit të brendshëm, Dëmeve, Financës, Juridike, Degës së Tiranës, shitjes së Tiranës.
2. Në zbatim të nenit 27/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe Udhëzimit nr.3, datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", brenda një afati kohor prej 45 ditësh, të hartohet rregullore për qëllimin, mënyrat e mbledhjes, ruajtjes dhe përpunimit, të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të "Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi".
3. Në rregulloren e përdorimit të këtij sistemi të parashikohet që aksesimi i këtij sistemi të behet vetëm lokalisht nga personi i autorizuar dhe jo nëpërmjet protokolleve të internetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

